



**Informimi javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°7/2022

Hagë, 24/02/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 22 shkurt 2022, u mbajt seanca për çështjen *Thaçi dhe të tjerë*, ku palët i paraqitën Gjykatësit të Procedurës Paraprake argumentet e tyre lidhur me administrimin e informacionit konfidencial dhe kontakteve me dëshmitarët.

Seanca e ardhshme për këtë çështje është planifikuar për datën 24 mars 2022, në orën 14:30.

Në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala*, më 22 shkurt, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi apelin e z. Shala kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake në të cilin rrëzohej Mocioni që Kundërshton Formën e Aktakuzës, i z. Shala.

Më 21 shkurt, Trupi Gjykses II urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë ende rreziku se, nëse z. Haradinaj dhe z. Gucati lirohen, do të pengojnë procesin ose do të përsërisin veprën penale për të cilën akuzohen apo do të kryejnë vepra penale të tjera.

Më 23 shkurt, Trupi Gjykses në çështjen *Mustafa* rrëzoi mocionin e Mbrojtjes në të cilin kërkohet rrëzimi i akuzave kundër të akuzuarit, në pajtim me rregullën 130 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Gjykimi për këtë çështje gjyqësore do të rifillojë më 8 mars në orën 09:30, kur është planifikuar të mbahet dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen.

Vendimet e Panelit të Gjykatës së Apelit dhe të Trupave Gjykses mund t'i gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

